

Npi – 01/251 datë: 21.10.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 26.10.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IX- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 26.10.2020 (e hënë) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Sylja, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj; Zyrtari për barazi Gjinore, z.Reshat Gashi; Zyrtari për Informim, Lulzim Sahiti; Praktikantja, znj.Sevdie Selimi; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Draft-Rregullore Komunale për Tatimin në Pronë për vitin 2021,
2. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/179 të Bahri Rexhaj, sipas kërkesës së MAPL-së,
3. Formimi i tri Komisioneve Vlerësuese, për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim,
4. Shqyrtimi i Kërkesave.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës, unë propozoj për miratim edhe dy pika shtesë të rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.08.2020,
2. Formimi i Komisionit për hartimin e “Kodit Etik” në Komunën e Shtimes.

Në vazhdim Kryesuesja hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, unë pajtohem me propozimin e rendit të ditës si dhe me dy pikat shtesë të propozuara nga Kryesuesja e Komitetit.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, nuk e di se a jemi në rregull me rregulloren e punës për procedimin ose futjen edhe të dy pikave shtesë të rendit të ditës të propozuara nga Kryesuesja.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Atëherë po e lëmë Ekstrakt Procesverbalin për mbledhjen e radhës, dhe po e shqyrtojmë mundësinë e futjes vetëm propozimin e dytë “Formimi i Komisionit për hartimin e “Kodit Etik” në Komunën e Shtimes”. Në vazhdim Kryesuesja konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që në rendin e ditës ta futë edhe pikën e pestë shtesë “Formimi i Komisionit për hartimin e “Kodit Etik” në Komunën e Shtimes.**

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht aprovoi rendin e ditës si vijon:**

- 1. Draft-Rregullore Komunale për Tatimin në Pronë për vitin 2021,**
- 2. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/179 të Bahri Rexhaj, sipas kërkesës së MAPL-së,**
- 3. Formimi i tri Komisioneve Vlerësuese, për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim,**
- 4. Shqyrtimi i Kërkesave,**
- 5. Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për hartimin e “Kodit Etik” në Komunën e Shtimes.**

Pika 1

Draft-Rregullore Komunale për Tatimin në Pronë për vitin 2021

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj. Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi Draft-Rregullore Komunale për Tatimin në Pronë për vitin 2021 sipas tabelave. Ajo tha se normat tatimore që i kemi propozuar në këtë rregullore janë më të ulëtat që nuk ka më poshtë, atëherë vetëm nëse ju dëshirini me i ngritë se me i ulë nuk ka më shumë mundësi. Kjo rregullore sipas Ligjit duhet të aprovohet në Kuvend për çdo vit. Sa i përket Kornizës Ligjore, e keni së bashku me dokumentin e shkruar që e keni marrë me kohë, prandaj unë ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit që ta aprovojë dhe nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur, (shih dokumentin).

z. Perparim Ramusa; Faleminderit për prezantimin që e bëre, meqenëse parashihet që kjo rregullore të shkojë në diskutim publik me qytetarë, edhe përkundër pandemisë jam që ta qojmë në diskutim publik.

znj. Arbresha Sylja; Përshëndetje, e dimë që kushtet për organizimin e diskutimit publik janë të kufizuara, prandaj ndoshta kishte me qenë mirë me organizuar takim me kryetarët e fshatrave e lagjeve urbane nga distanca On-line, sepse mendoj se edhe ne por edhe ata duhet me e dhënë kontributin e tyre në këtë rregullore, e cila është drejtpërdrejt në interesin e banorëve. Unë kisha dashtë me ditë se far plani ka Ekzekutivi lidhur me këtë?

z. Naim Zejna; Përshëndetje, kjo ndikon direkt te Buxheti, për këtë arsye kjo rregullore është mirë me ardhur për shqyrtim para Buxhetit. Te ndarja e Hartave Zonale, duhet të bëhet një ndarje më precize më e butë ndërmjet zonave, ndoshta do të ishte mirë që ndarja të bëhet edhe me pika sikurse A, B, C që kishin me e zbutë ndarjen në mes një zone me zonën tjetër, e jo me pasë përshkallëzim të lartë. Prandaj unë mendoj se është mirë që me marrë parasysh edhe shtyrjen e kësaj pike.

znj. Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Kuvendi i Komunës i cakton normat tatimore, të tjerat janë caktuar me Ligj. E thash pra që këto norma tatimore janë më të ulëtat, skemi se ku shkojmë më poshtë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregullore Komunale për Tatimin në Pronë për vitin 2021.**

Pika 2

Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/179 të Bahri Rexhaj, sipas kërkesës së MAPL-së

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Prezantoi këtë kërkesë të MAPL-së, dhe hapi diskutimin.

z. Perparim Ramusa; Normal është që duhet mbështetur kërkesa, por problemi është se MAPL-ja ka thënë se vendimi që është marrë është në kundërshtim me Ligjin, prandaj për këtë arsye unë propozoj që të anulohet.

znj. Adelina Beqaj; Përshëndetje, edhe unë propozoj që ky vendim të anulohet dhe të shohim më tutje.

z. Naim Zejna; Edhe unë jam për zbatimin e Ligjit, mirëpo për të gjithë njësoj, kështu pra duhet të vepohet për të gjitha kërkesat.

znj.Arbresha Sylja; Ne jemi për me bërë zgjidhje, ne e kemi marrë këtë vendim, dhe ne duhet me e anuluar këtë vendim sipas kërkesës së MAPL-së, dhe shumë shpejt me i dhënë palës një përgjigje, të qartë.

z.Perparim Ramusa; Ne jemi të obliguar për me i zbatuar vendimet e MAPL-së, sepse ky vendim është i pa ligjshëm. Duhet me gjetë formë ligjore për zgjidhjen e kësaj çështje.

z.Naim Zejna; Problemi është se rekomandimin e MAPL-së nuk jemi të obliguar ta zbatojmë. Unë po kërkoj që të vendoset njëjtë për të gjitha kërkesat e natyrës së njëjtë e jo në mënyrë selektive.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lidhur me këtë çështje kemi edhe një kërkesë tjetër të re të palës e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi që faktikisht MAPL-ja ka thënë se duhet të anulohet. Pala ka kërkuar që parcelave të Komunës që është kërkuar të këmbehen me ju shtuar edhe një parcelë tjetër.

znj.Zarife Rexhaj; Përshëndetje, po keqkuptohet kërkesa e MAPL-së kur po thuhet që të anulohet vendimi, MAPL-ja në fakt ka thënë që vendimi të rishqyrtohet.

z.Perparim Ramusa; Ne këtu nuk jemi Jurista, por unë mendoj se ne nuk kemi qare pa e anuluar këtë vendim, për faktin se është thënë se është në kundërshtim me Ligjin. Nëse duem me bërë zgjidhje për këtë çështje atëherë duhet ta bëjmë me një kërkesë tjetër në rrugë ligjore.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, fillimisht kërkoj falje për vonesën. Nuk është vetëm ky vendim, por ka edhe kërkesa e vendime tjera që janë në kundërshtim me Ligjin. Kemi vendime që janë marrë në këtë Kuvend pa qenë fare në rendin e ditës. Kryetari me Kryesuesen e Kuvendit po punojnë kryesisht në kundërshtim me Ligjin. Ku është Zyrtari Ligjorë, ai duhet me qenë prezent në mbledhje për me na dhënë sqarimet e nevojshme. Ky vendim duhet me u anuluar dhe pikë, jo pse po duam ne por për shkak se është në kundërshtim me Ligjin, dhe kështu e ka thënë edhe MAPL-ja.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim", vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, Anulimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/179 të Bahri Rexhaj-Petrovë, sipas kërkesës së MAPL-së.**

Pika 3

Formimi i tri Komisioneve Vlerësuese, për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Prezantoi këtë pikë duke lexuar të tri Propozim-Vendimet e Kryetarit, dhe hapi diskutimin.

znj.Adelina Beqaj; Unë propozoj që kjo pikë të shkojë direkt në Kuvend, që të bëhet zgjedhja e Komisioneve në mënyrë demokratike, sepse në Kuvend janë prezent të gjitha subjektet politike.

z.Perparim Ramusa; Edhe unë sikurse Adelina, jam që të formohen Komisionet, por që të shkojnë direkt në Kuvend.

z.Naim Zejna; Takort, por a do të jetë në kundërshtim me Ligjin, që ka thënë MAPL-ja për listën e pronave. Pastaj e dyta, Imer Tërshani, a është i njëjti që është në Komisionin për Ankesa, nëse po unë mendoj se këtu kemi konflikt interesi.

z.Ruzhdi Jashari; Sa i përket këtyre tri propozim-vendimeve, unë mendoj se së pari duhet me bërë inventarizimin e pronave komunale dhe me u shpallë kjo listë publike, para se me u shpallë prona me interes të përgjithshëm. Këto po shihet që janë të gjitha pazare parazgjedhore të Kryetarit. Duhet me bërë së pari Listën e pronave komunale që planifikohet me u dhënë në shfrytëzim. Këto pra janë në kundërshtim me Ligjin, e tash thuhet për formimin e komisioneve, ndërkaq u përmend edhe konflikti e interesit aty.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Unë i kam lexuar të gjitha fjalët nga Rozafa-MAPL-ë. Në vazhdim Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim", vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, që të vendos vetë direkt pa rekomandim, me arsyetimin se në Kuvend janë prezent të gjithë anëtarët e subjekteve politike.**

Pika 4

Shqyrtimi i Kërkesave

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Lexoi, Kërkesat si vijon, dhe hapi diskutimin për këtë kërkesë:

1. z. Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z. Kemajl Ademaj me zyrën e Avokatisë në Ferizaj Rr. "Hamëz Jashari" p.n. Kërkesa Nr.01-070/05-19162/20 datë:24.09.2020.

znj. Adelina Beqaj; Po më duket absurde çështja e një kërkesë që ne nuk po mundemi me vendosë për në parcelë me ndrruar me një parcelë tjetër. Unë personalisht nuk kam gjë kundër Bahri Rexhaj.

z. Naim Zejna; Le ti vlerësojnë pronat drejtoritë sepse i kanë zyrtarët, kanë mundur me dhënë një rekomandim.

z. Perparim Ramusa; Nuk ka nevojë me i pshtjellë punët sepse janë të qarta, ne jemi ata që vendosim. Unë propozoj që kërkesa të shtyhet për një muaj.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim",** vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, që ta shtyj shqyrtimin e Kërkesës Nr.01-070/05-19162/20 të Bahri Rexhaj – Petrovë, deri në mbledhjen e radhës, sipas rekomandimit të DPUKGJ-së me arsyetimin se kjo kërkon edhe verifikim edhe matje të parcelave në teren nga gjeodetet e Komunës.

2. z. Bekim Osmani – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-19428/20 datë:29.09.2020.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë kërkesë:

z. Perparim Ramusa; Është logjike që edhe këtë kërkesë ta shtyejmë. Mendoj se për këtë çështje kompetente duhet të jetë Agjencioni për mbrojtjen e Monumenteve Memoriale.

z. Ruzhdi Jashari; Kur bëhet fjalë për Kompleksin, hallka e parë është kompetente Komuna, për me bërë shpallje me interes të përgjithshëm. Hallka e dytë pastaj është Agjencioni. Edhe rrugët janë të nivelit qëndror, por ne jemi hallka e parë. Ajo që është në kuadër të Kompleksit Memorial të Raçakut, duhet filluar menjëher procedura e shpronësimit.

znj. Zarife Rexhaj; Edhe unë jam për me e shty, por drejtoria nuk po është në gjendje me dhënë një rekomandim konkret, por veq të konsumohet koha kot, të shtyhet të shtyhet kjo nuk është zgjidhje.

znj. Adelina Beqaj; Unë rekomandoj që mos të ngutemi, sepse ka edhe banorë të tjerë me kërkesa të njëjta, kështu që ne duhet që ti trajtojmë të gjitha kërkesat në mënyrë të barabartë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim",** vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, që ta shtyj shqyrtimin e Kërkesës Nr.01-070/05-19428/20 të Bekim Osmanit – Raçak, sipas Rekomandimit të DPUKGJ-së.

3. z. Xhevdet Mehmeti, Rr. "15 Janari" Nr.233 fshati Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-20118/20 datë: 08.10.2020.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë kërkesë:

z. Perparim Ramusa; Te kjo kërkesë unë nuk pajtohem me rekomandimin e drejtorisë, sepse ka vendime të ngjashme që kemi vendosur "Për" lidhur me disa kërkesa të tjera të ngjashme.

z. Naim Zejna; Pajtohem edhe unë me mendimin e Perparimit, por është një vërejtje e madhe për ekzekutivin që është bërë rruga pe e matur paraprakisht.

z. Ruzhdi Jashari; Sa kohë ka që është shtruar rruga "15 Janari" në Raçak, edhe sot po shtrihen rrugë pa bërë kurrfar matjesh, e pastaj po na dalin kërkesat për shpronësim.

znj. Arbresha Sylja; A e din ti, se kur është shtruar rruga për Godanc. Këso pyetjesh se kur u shtrua filan rruga, me mënyrën qysh po përgjigjesh, dhe me këso lloj shprehjesh unë kërkoj që të bëhet një kod i mirësjelljes dhe në momentin e parë që shkilet nga secili të thirret sigurimi dhe të nxirret jashtë. Po na fyen e po na ofendon, unë nuk e kuptoj mënyrën e sjelljes së tijë. Kërkoj prej medieve që me e përcjellë mirë gjuhën e përdorur parlamentare të Kuvendarit zotëri Ruzhdi Jasharit në Kuvend. Propozoj që Kuvendi të inicon Kodin e mirësjelljes, ju Kryesuese me e shqyrtuar këtë çështje mirë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Kryesuesja ka plan tjetër lidhur me këtë, jo vetëm me zotëri Jasharin por me të gjithë ata që kanë gjuhë ofenduese ndaj femrave, dhe këtë plan unë kam me e vazhduar dhe kam me e përfunduar, edhe pse një kohë e kam lënë për hirë të respektit, mirëpo po e shohë që nuk po marr respekt të ndërsjelltë, konkretisht kur po flitet për zotëri Jasharin atëherë kjo mua më detyron për me e hudhë një hap më tutje. Kte kam me e bërë shumë shpejt, sepse unë që nga fillimi kam qenë e atakuar, kështu që ju nuk jeni pa mbrojtje. Me momentin kur unë e kam marrë ulësen në këtë Kuvend zotëri Jashari ka pasë thirrje prej më banale në pozicionin që unë jam. Por mua nuk më bëhet shumë vonë sepse unë vetëm blej nga kjo, dhe jam vetëm duke mbledhur fakte. Unë të falenderohem për sakrificat në drejtim timin e që unë i kam tejkaluar dhe vetem sa jam ngritur.

z. Ruzhdi Jashari; Unë mund të ju them se jam i kënaqur me punën time, sepse unë jam për me i shty çështjet përpara. Por për ata që e prekin aspektin Ligjorë unë jam i pa kompromis. Unë do ti luftoj dukuritë e kqija, por vetem ato që unë i shohë me sytë e mi. Ju pra jeni aty vetëm për me i mbuluar çështjet e ekzekutivit, e jo në shërbim të Kuvendit.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Unë kërkoj nga administrata që të na sillat lista e përbashkët e shpronësimeve ashtu siç ka thënë DPUKGJ-ja. Në vazhdim Kryesuesja konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, që Kërkesa Nr.01-070/05-20118/20, e Xhevdet Mehmetit – Raçak, të futet në listën e pronave për shpronësim.**


Pika 5 (Pikë Shtesë)

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për hartimin e “Kodit Etik” në Komunën e Shtimes.
Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk kishte diskutime Kryesuesja konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që kjo pikë të shkojë direkt në Kuvend pa rekomandim.**

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi ne ora 11.14h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

